



REPUBLIKA E SHqipërisë

**BASHKIA VLORE
KESHILLI I BASHKISE**

Nr 7219 Prot

Vlorë, më 15.04 2026

Lënda: Njoftim për mbledhjen jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë, datë 20.04.2026.

ANËTARËVE TË KESHILLIT TË BASHKISË VLORE

**Për dijeni: KRYETARIT TË BASHKISË VLORE
PREFEKTIT TË QARKUT VLORE**

Ju njoftoj se, **ditën e hënë, datë 20.04.2026, ora 10:00**, në Pallatin e Kulturës “Labëria” do të zhvillohet mbledhje jashtë radhe e Këshillit të Bashkisë Vlorë, e thirrur nga Kryetare e Bashkisë, në bazë të Ligjit Nr. 139/2015, neni 53 pika 3/a, me rend dite si vijon;

1. Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 100, datë 23.12.2025 “Për Buxhetin e Bashkisë Vlorë për vitin 2026”.
2. Projektvendim “Për miratimin e tarifës së ofrimit të shërbimit për zonën e plazheve, të administruara dhe të tarifuar nga Njësia e Vetëqeverisjes Vendore”.
3. Projektvendim “Për përcaktimin e vendqëndrimit të mjeteve, për të cilat janë vendosur masa administrative (gjoba) për shkelje të Kodit Rrugor”.
4. Projektvendim “Për krijimin e strehëzës së kafshëve endacakë dhe, miratimin e akteve administrative, në funksion të kësaj veprimtarie”.
5. Projektvendim “Për disa shtesa dhe ndryshime në VKB Nr 98, datë 27.11.2025 “Për miratimin e numrit të punonjësve dhe nivelit të pagave të bashkisë, institucioneve të varësisë dhe funksioneve të deleguara – 2026” të ndryshuar.

Kryesia e Këshillit të Bashkisë, u mbledh në mjediset e Bashkisë Vlorë, datë 15.04.2026, ora 12:40.
Komisionet e përhershme, do të mblidhen në mjediset e Bashkisë Vlorë, si më poshtë :
Komisioni juridik, i rendit dhe i sigurisë vendore publike, do të mblidhet ditën e premte , datë 17.04 .2026 , ora 09:00.

Komisioni për çështjet e ekonomisë, financave dhe privatizimet, do të mbledhet ditën e premte , datë 17.04 .2026 , ora 10:00.

Komisioni i shërbimeve publike, transportit, infrastrukturës dhe strehimit, do të mbledhet ditën e premte, datë 17.04.2026 , ora 11:30.

Komisioni i shëndetësisë, veterinarisë, mjedisit dhe zhvillimit të turizmit, do të mbledhet ditën e premte, datë 17.04.2026 , ora 12:30.

V.O. Bazuar në rendin e ditës të sipërcituar, nëse ndonjë nga Komisionet e Përhershme, vlerëson se, duhet të mbledhet për çështjet që trajtojnë projektvendimet, Kryetari i Komisionit të njoftojë anëtarët e komisionit përkatës, për datën dhe orën e mbledhjes.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VLORË
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 7218 Prot.

Vlorë, më 15.04, 2026

VENDIM

Nr 4, datë 15.04.2026

**“MIRATIMI I NJOFTIMIT DHE RENDIT TË DITËS PËR MBLEDHJEN JASHTË
RADHE”**

Në mbështetje të Ligjit Nr 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Neni 53, pika 3/a; Neni 56, pika 2 dhe, Rregulloren “Për Organizmin dhe Funkionimin e Këshillit të Bashkisë Vlorë” Neni 60, pikat 1/a, 2 dhe 3, Kryesia e Këshillit të Bashkisë Vlorë, në mbledhjen e datës 15.04.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e njoftimit dhe rendit të ditës për mbledhjen jashtë radhe të Këshillit të Bashkisë Vlorë, e cila do të mbahet në datën 20.04.2026.
2. Ngarkohet Sekretari i Këshillit dhe, në mungesë të tij, Kryetari i Këshillit për bërjen publike të njoftimit dhe rendit të ditës së mbledhjes dhe dërgimin e njoftimit dhe rendit të ditës te çdo këshilltar, te Kryetari i Bashkisë Vlorë, Deputetët e Bashkisë Vlorë dhe personat apo/dhe organizatat që kanë paraqitur kërkesë për të marrë njoftim të rregullt, si dhe përgatitjen e materialeve të mbledhjes dhe dërgimin e tyre te secili këshilltar dhe te Kryetari i Bashkisë Vlorë.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

Elpiniqi Mërkuri

